

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT


Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KRU "Hidromorava" sh.a  
 Për Aktivitetin e Prokurimit: KRU 2017 001 236  
 Sa i përket tenderit për: Vendorsja dhe mirëmbajtja e GPS-ve në Automjete

## ANKESË

## 1. Identifikimi i ankuesit \*

PBC sh.p.k.



(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Hamdi Mramori p.n.

(Adresa)

Pristine

10 000

(Vendi)

(Kodi postar)

038 600 200

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Bashkim Selmani

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

bashkim@pbc-ks.com

(Adresa elektronike)

24.02.2017

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

N/A

(Emri i avokatit)

N/A

(Adresa e plotë)

N/A

(Numri i Telefonit)

N/A

(Numri i faks-it)

N/A

(Adresa elektronike)

N/A

(Data e parashtrimit të kërkesës)

N/A

(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].*

Njoftimi për Kontratë:	14.02.2017
Kërkesa për rishqyrtim të vendimit nga AK (108/A):	16.02.2017
Afati i fundit për dorëzimin e tenderit:	21.02.2017
Shtyra e afatit për dorëzim të ofertave	21.02.2017
Afati i fundit për dorëzimin e tenderit:	24.02.2017
Kriteri për dhënie të kontratës: çmimi më i ulët i përgjegjshëm	

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet**

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifíkoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

Kjo ankesë dorëzohet para afatit të fundit për dorëzimin e ofertave.

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet**

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit?

Po

☐

Jo

☐**6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Ne si operator ekonomik, brenda afatit të paraparë ligjor sipas Nenit 108/A të Ligjit për Prokurim Publik i kemi dërguar kërkesën për Rishqyrtim mbi supozimet tona të dëshmuara me prova të emeruara nga ne si "Provë A", "Provë B" dhe "Provë C" që specifikat janë favorizuese për një prodhues, kërkesë mbi të cilën kemi pranuar përgjigje jo adekuate përkatësisht kemi pranuar përgjigjeje/vendim për diçka që nuk ka qene pjesë e kërkesës sonë.

Provë A: Kërkesa për Shqyrtim nga ana jonë, sipas Nenit 108/A të Ligjit për Prokurim Publik,

Provë B: Vendimi i Autoritetit Kontraktues

Provë C: Reagimi i jone ne vendimin e Autoritetit Kontraktues

Nga kjo që shihet më sipër vlenë të veçohet se:

1. Autoriteti Kontraktues nuk ka marr për bazë argumentet e parashtruara nga ana jonë me rastin e kërkeses për rishqyrtim dhe reagimit tone ndaj vendimit të Autoritetit Kontraktues.

Andaj, bazuar në këto që u theksuan më sipër, veçanërisht provave korrespoduese dhe elaborimeve që gjenden në vazhdim, parashtrojmë ankesë, në kuadër të normave dhe afateve kohore.

**7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues, me vetëdije, kërcënon me shkelje:

- Paragrafin e 2-të të nenit 7 të Ligjit për Prokurim Publik
- Nen-Parafin e (iii) te paragrafit gjashtë (6) te nenit 7
- Paragrafin e 2-të nenit 28 të Ligjit për Prokurim Publik



\*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

1. Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur paragrafin 2 të nenin 7 nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, sepse:
  - a. Nuk ka krijuar kushte për trajtim në mënyrë të barabartë Operatorit Ekonomik duke ekzekutuar aspekte të aktivitetit të prokurimit të cilat në një mënyrë reduktojnë dhe eliminojnë konkurrencën mes operatoreve ekonomik, respektivisht duke diskriminuar një ose me shumë operator ekonomik.
2. Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nën-paragrafin e (iii) të paragrafit 6 të nenit 7 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, sepse:
  - b. Ka përpiluar kritere, kërkesa dhe specifikacion teknike që eliminon e diskriminon operatorët ekonomik, e favorizon një ose disa operator ekonomik, respektivisht ka vendosur kërkesa ose kritere të përzgjedhjes, gjegjësisht
    - kërkesa për Autorizim nga prodhuesi – MAF
    - Kërkesa që Operatori Ekonomik të ketë ISO certifikatë (faqe 7) e njëjte edhe kërkesa për ISO27001 certifikatë të prodhuesit (faqe 17) e që ka krijuar kushte për favorizimin ose diskriminimin kundër njërit ose më shumë operatoreve ekonomik, për shkakun se ASNJE procedurë e implementimit të kontratës nuk i referohet procesit të standardizuar me ISO standarde.
3. Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur paragrafin 2 të nenin 7 dhe paragrafin e 2-të të nenit 28 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, sepse:
  - a. Në procedurën e prokurimit në fjalë, autoriteti kontraktues ka përpiluar specifikacion teknik që nuk sigurojnë qasje të barabartë për operatorët ekonomik që janë të interesuar për këtë procedurë të prokurimit, dhe, ka ekzekutuar aspekte që favorizojnë një prodhues e diskriminojnë të gjithë e tjerët.

Në vazhdim po i paraqesim disa nga diskriminimet dhe favorizimet ndaj OE të caktuara nga Autoriteti Kontraktues.

**Prova 1:** The data center will be established in a country member state of the European



Union.

Kërkesa AK-s, e emëruar nga ne si "Prova 1", përben shkelje të rënde të nenit 28 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 pasi që, është kërkuar që hostimi i platformës të realizohet vetëm në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, me c'rast është favorizuar OE nga Kroacia "Smartivo" dhe janë diskriminuar OE rajonal dhe vendor.

**Prova 2:** The system must allow access to information on the fleet via native applications dedicated to iOS and Android. The Mobile Application must be downloaded from Google Play and App Store. For this requirement no alternatives desktop applications to be responsive on mobile devices will be accepted.

Kërkesa AK-s, e emëruar nga ne si "Prova 2", përben shkelje të rënd të nenit 28 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 pasi që këtë kërkesë e plotëson vetëm OE Smartivo.

Për informaten tuaj, në linkun e më poshte mund të shihet qartë favorizimi ndaj ketij OE: <http://smartivo.com/en/faq/#toggle-id-19>

**Prova 3:** The system must be able to connect to the vehicle's CAN interface if FMS protocol is available.

Kërkesa AK-s, e emëruar nga ne si "Prova 3", përben shkelje të rënde të nenit 28 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 pasi që kërkesën për FMS interface e plotëson vetëm OE Smartivo.

Per informaten tuaj, në linkun më poshte mund të shihet qartë favorizimi ndaj ketij OE: <http://smartivo.com/en/features/>

Nga ajo që shihet dhe, fuqishëm është theksuar më sipër, shihet qartë se ka ndodhur një mal shellesh ligjore përgjatë përpilimit të kriterëve të përzgjedhjes dhe specifikacioneve teknike. Për këtë arsye kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit ta kthej këtë lëndë në RITENDERIM OSE TA OBLIGOJ AUTORITETIN KONTRAKTUES TI RISHIKOJ TERMAT E REFERENCES DHE TE ELIMINOJ ATO QE DISKRIMINUESE.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Demet materiale per kompaninë tone sillen rreth 1.000 euro, si fitim i mundshëm, ndërsa per AK'ne janë multi-dispilarë. Te dyja këto mund te evitohen me nje lehtësi te jashtëzakonshme nga Autoriteti Kontraktues dhe te mundësohet realizim i suksesshëm i kontratës.

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

- a. Kopja e publikimit të "Njoftimit për Kontratë"

- b. Kopja e 'Kërkesës për Rishqyrtim', sipas nenin 108/A
- c. Kopja e shkresës nga AK për vazhdim të afatit për dorëzimin e ofertave
- d. Kopja e vendimit nga Autoritetit Kontraktues
- e. Kopja e reagimit të vendimit të Autoritetit Kontraktues
- f. Prova "1" e cila dëshmon se vetëm OE Smartivo plotëson kërkesën teknike të parashtruar nga AK.
- g. Prova "2" e cila dëshmon se vetëm OE Smartivo, plotëson kërkesën teknike të parashtruar nga AK
- h. Prova "3" e cila dëshmon se vetëm OE Smartivo, plotëson kërkesën teknike të parashtruar nga AK

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues*